

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EMA-ALIS" SHPK

Sot me daten 14/06/2023 (dymijë e njëzet e tre), unë ortaku themelues :

- **1 Z.Seid Krasnaj**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 27 Qershor 1988, lindur në Bago dhe Bago në Kavaje, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (pasaporte) me Nr. I80627118Q.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "EMA-ALIS" SHPK.*

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " EMA-ALIS" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Kavajë,ndërtesë me numër pasurie 9/64+1-18 vol.3,fq.44,zk 8552,Lagjja Asguri,Kavajë

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Tregti peshku,import,eksport,zenie,transport peshku.Import ,eksport,mbjellje të produkteve bujqësore. Veprimtaria e rritjes së kafshëve. Inkubimin e zogjve për vezë dhe broiler. Import, eksportin e zogjve të shpendëve (pula, rosa, pata, etj). Prodhimin, përpunimin, transformimin dhe konfeksionimin e vezëve, prodhimeve të tjera dhe të derivateve të tyre. Prodhimin e ushqimeve të integruara dhe bilancuara për kafshët.Tregtimin me shumicë të gjithë artikujve.Agjensi punesimi per te huaj dhe shqiptare.Marrje tokash me qira.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " EMA-ALIS" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

1. Seid Krasnaj zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.



NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Seid Krasnaj**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhje.



ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
"EMA-ALIS" SH.P.K
Seid Krasnaj

Seid Krasnaj

